

VENDIM
Nr. 28, datë 30.1.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
LUÇENTE KONCESIONARE SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC SPATHARË,
ME FUQI 1038 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Luçente Koncesionare sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi 1038 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 11 prot., datë 9.1.2018, shoqëria Luçente Koncesionare sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi 1038 kw.

- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim rezulton, se shoqëria Luçente Koncesionare sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 7, pika 2, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, gjerat “a” (prokurën e aplikuesit për përfaqësimin e tij) dhe “b” (vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë, vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

- Nenin 8, pika 3 (dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit).

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim që personi dhe drejtuesit kryesorë të tij në rastin e personave juridikë nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

- Nenin 9, pika 2, germa “f” (marrëveshja e koncesionit, mungesa e faqes së fundit të saj me nënshkrimet e palëve);

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë

elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Luçente Koncesionare sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Spatharë, me fuqi të instaluar 1038 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti